

KIRNF Interpretimi 22

Transaksionet dhe paradhënia në monedhë të huaj

Referencat

- *Kuadri konceptual për raportimin financiar*¹
- SNK 8 *Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet*
- SNK 21 *Efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit në monedhat e huaja*

Konteksti

- 1 Paragrafi 21 i SNK 21 *Efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit* kërkon që një njësi ekonomike të regjistrojë një transaksion në monedhë të huaj, në momentin e njohjes fillestare, në monedhën e saj funksionale duke shumëzuar shumën në valutë të huaj me kursin e këmbimit të çastit midis monedhës funksionale dhe monedhës së huaj (kursi i këmbimit) në datën e transaksionit. Paragrafi 22 i SNK 21 thotë se data e transaksionit është data në të cilën transaksioni fillimisht kualifikohet për njohje në përputhje me Standardet e SNRF-ve (Standardet).
- 2 Kur një njësi ekonomike paguan ose merr një shumë paradhënie në një monedhë të huaj, ajo në përgjithësi njeh një aktiv jo-monetar ose një detyrim jo-monetar² përpara se të njohë aktivin, shpenzimin ose të ardhurën që ka lidhje me të. Aktivin, shpenzimin ose të ardhurën përkatëse (ose një pjesë e saj) është shuma e njohur sipas zbatimit të Standardeve përkatëse, gjë që rezulton në çregjistrimin e aktivit jo-monetar ose detyrimit jo-monetar të krijuar nga shuma paradhënie.
- 3 Komiteti i Interpretimeve të SNRF-ve (Komiteti i Interpretimeve) fillimisht mori një pyetje ku kërkohej se si duhet të përcaktohet "data e transaksionit" duke zbatuar paragrafët 21-22 të SNK 21 kur njihen të ardhurat. Pyetja në mënyrë të veçantë adresonte rrethanat në të cilat një njësi ekonomike njeh një detyrim jo-monetar që rrjedh nga marrja e një shume paradhënie përpara se të njohë të ardhurat që kanë lidhje me të. Në diskutimin e çështjes, Komiteti i Interpretimeve vuri në dukje se marrja ose pagesa e shumës paradhënie në një monedhë të huaj nuk kufizohet nga transaksionet e të ardhurave. Prandaj, Komiteti i Interpretimeve vendosi të sqarojë datën e transaksionit me qëllim që të përcaktonte kursin e këmbimit për t'u përdorur në njohjen fillestare të aktivit, të shpenzimeve ose të ardhurave që janë të lidhura me paradhënien, kur një njësi ekonomike ka marrë ose ka paguar paradhënie në monedhë të huaj.

Objekti

- 4 Ky Interpretim zbatohet për një transaksion në monedhë të huaj (ose një pjesë e saj) kur një njësi ekonomike njeh një aktiv jo-monetar ose detyrim jo-monetar që rrjedh nga pagesa ose marrja e shumës paradhënie përpara se njësia ekonomike të njohë aktivin, shpenzimet ose të ardhurat përkatëse (ose një pjesë e tyre).
- 5 Ky Interpretim nuk zbatohet kur njësia ekonomike mat aktivin, shpenzimet ose të ardhurat përkatëse në njohjen e tyre fillestare:
 - (a) me vlerën e drejtë; ose
 - (b) me vlerën e drejtë të shumës së paguar ose të marrë në një datë të ndryshme nga data e njohjes fillestare e aktivit jo-monetar ose detyrimit jo-monetar që rrjedh nga shuma paradhënie (për shembull, matja e emrit të mirë sipas SNRF 3 *Kombinimet e biznesit*).
- 6 Një njësi ekonomike nuk është e detyruar të zbatojë këtë Interpretim për:
 - (a) tatimi mbi fitimin; ose

¹ Referenca është për *Kuadrin konceptual të raportimit financiar*, të publikuar në vitin 2010 dhe që u fut në fuqi në kohën kur u përgatit Interpretimi.

² Për shembull, paragrafi 106 i SNRF 15 *Të Ardhurat nga kontratat me konsumatorët* kërkon që nëse një klient paguan paradhënie, ose një njësi ekonomike ka të drejtë mbi një shumë të pretenduar paradhënie që është e pakushtëzuar (p.sh. një e drejtë e arkëtueshme), përpara se njësia ekonomike të transferojë një mall ose shërbim tek klienti, njësia ekonomike do të paraqesë kontratën si një detyrim kontraktual kur pagesa është bërë ose pagesa është e detyrueshme (cilado që është më e hershme).

- (b) kontratat e sigurimit (përfshirë kontratat e ri sigurimit) që ajo lëshon dhe kontratat e ri sigurimit që ajo mban.

Çështja

- 7 Ky Interpretim adreson mënyrën e përcaktimit të datës së transaksionit për përcaktimin e kursit të këmbimit që duhet përdorur si në njohjen fillestare të aktivit, shpenzimit ose të ardhurave (ose një pjese të tyre) që lidhen me paradhënien, ashtu dhe në çregjistrimin e një aktivi jo-monetar ose detyrim jo-monetar që rrjedh nga pagesa ose marrja e paradhënies në monedhë të huaj.

Konsensusi

- 8 Në zbatim të paragrafëve 21-22 të SNK 21, data e transaksionit për qëllime të përcaktimit të kursit të këmbimit që duhet përdorur në njohjen fillestare të aktivit, shpenzimeve ose të ardhurave (ose një pjese të tyre), është data në të cilën një njësi ekonomike njeh fillimisht aktivin jo-monetar ose detyrimin jo-monetar që rrjedh nga pagesa ose marrja e shumës paradhënie.
- 9 Nëse ka pagesa të shumta të bëra ose të marra në formë paradhënie, njësi ekonomike do të përcaktojë një datë për çdo transaksion pagese të bërë ose të marrë të shumës paradhënie.

Shtojca A

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

Kjo shtojcë është një pjesë përbërëse e KIRNF 22 dhe ka të njëjtin autoritet si pjesët e tjera të KIRNF 22.

Data e hyrjes në fuqi

- A1 Një njësi ekonomike do ta zbatojë këtë Interpretim për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2018 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë Interpretim për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

Periudha kalimtare

- A2 Gjatë zbatimit fillestar, një njësi ekonomike do të zbatojë këtë Interpretim ose:
- (a) SNK 8 *Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet*; ose
 - (b) në mënyrë prospektive për të gjitha aktivet, shpenzimet dhe të ardhurat që bëjnë pjesë në fushën e këtij Interpretimit si të njohura për herë të parë ose më pas:
 - (i) në datën e fillimit të periudhës raportuese në të cilën njësia për herë të parë zbaton këtë Interpretim dhe në vijim; ose
 - (ii) në datën e fillimit të një periudhe raportuese paraprake të paraqitur si informacion krahasues në pasqyrat financiare të periudhës raportuese në të cilën njësia për herë të parë zbaton këtë Interpretim dhe në vijim.
- A3 Një njësi ekonomike që zbaton paragrafin A2 (b) në zbatimin e saj për për herë të parë do të zbatojë këtë Interpretim për aktivet, shpenzimet dhe të ardhurat e njohura për herë të parë në datën e fillimit të periudhës raportuese në paragrafin A2 (b) (i) ose (ii), për të cilat njësia ekonomike ka njohur aktive jo-monetare ose detyrime jo-monetare që rrjedhin nga shumat paradhënie përpara kësaj date, dhe në vijim.

